



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Kuvendi i Komunës-
01Nr.16-7946/2011
Kaçanik, 31.10.2011

Duke u bazuar në Rekomandimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) të datës 15 shtator 2011 për Harmonizimin e Rregullores për Transparencë Komunale 01Nr. 16-7946 të aprovuar nga kuvendi i komunës më datë: 29.07.2011, më Ligjin Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike dhe Udhëzimin Administrativ Nr.2008/9 për Transparencë Komunale, në bazë të Propozim-Vendimit të kryetarit të komunës nga data: 25.10.2011, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 31.10.2011, mori:

V E N D I M
PËR NDRYSHIM- PLOTËSIMIN E RREGULLORES 01NR. 16-7946/2011
PËR TRANSPARENCË KOMUNALE

I.

Me këtë Vendim, ndryshohen dhe plotësohet Rregullorja 01Nr.16-7946/2011- Për Transparencë Komunale e aprovuar nga Kuvendi i Komunës Kaçanik, më datë: 29.07.2011.

II.

Ndryshim Plotësimet e Rregullorës së përcaktuar si në pikën I. Të këtij Vendimi bëhen si në vijim:

Në Preambulë të Rregullorës, ku janë marrë për bazë aktet për nxjerrjen e Rregullorës për Transparencë, hiqet pasuesi: “Ligji për Qasje në Dokumentet Zyrtare Nr. 2003/12” dhe shtohet pasuesi; “Ligji Nr.03/L-215 për Qasje në Dokumentet Publike”.

Ne nenin 2 të Rregullores i shtohet fjalia : “detyrimin për njoftim publik” ashtu siç është përcaktua në nenin 2 të Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/9 për Transparencën komunale.

Në Nenin 6, pika 2,3 dhe 4 bëhen ndryshimet dhe plotësimet dhe harmonizimet me nenin 68 pika 1 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/ L-040 dhe nenin 6 pika 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 2008/9 për Transparencë në komuna. Pika 2, 3 dhe 4 pas ndryshimeve dhe harmonizimeve janë siç vijon:

2. Takimet e rregullta me publikun janë të hapura për opinion dhe bëhen publike dy javë para datës së mbajtjes së tubimit” përmes zyrës për informim.

3. Zyra për Informim njofton publikun përmes:

- Shpalljeve publike në vendet më të frekuentuara brenda territorit të komunës;
- Njoftimi i mediave të shkruara dhe elektronike; dhe
- Njoftimit përmes faqes zyrtare komunale

4. Njoftimi publik sipas paragrafit 3 të nenit 6, duhet të përmbajë:

- Datën e takimit;
- Kohën e takimit; -
- Vendin e takimit dhe
- Rendin e ditës

III.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e aprovimit nga kuvendi i komunës dhe është pjesë përbërse e Rregullorës 01Nr. 16-7946/2011 për Transparencë Komunale.

Kryesuesi i kuvendit,
z. Xhelal Gashi